

Kështu përfitohet nga rritja e viçave të vegjël



Kostoja e rritjes së viçave është e lartë. Por si përmirësohet përfitimi? Numri i saktë i viçave, lindja e viçit të parë në moshë të re dhe një ecuri e mirë e viçave është vendimtare për suksesin.

Bazuar në rezultatet e studimeve të vitit 2015 mbi tufat (Dhoma e Bujqësisë Schleswig- Holstein), kostot totale të rritjes, mesatarisht për 502 ferma të analizuara, kapin një vlerë prej 1.652 Euro. Kostot direkte rezultuan 1.242 Euro për mëshqerra në lindjen e parë në një moshë 29 muajshe, rezultate të cilat mund të përmirësohen.

Numri i viçave dhe moshë në lindjen e parë

Sa më i lartë numri i kafshëve të remontit, aq më shumë mëshqerra nevojiten. Kur numri i kafshëve të remontit rritet ndjeshëm mbi 40%, atëherë pasardhësit nuk mjaftojnë për zëvendësimin e tyre (tabela 1). Kur rritet moshë e lindjes së parë, duhet të rritet dhe kontigjenti i kafshë për remont. Kjo do të thotë më shumë kapacitet në stallë, më shumë ushqim, më shumë ngarkesë pune. Ulja e moshës në lindjen e parë redukton kostot e rritjes. Studimet ndërkombëtare tregojnë gjithashtu se, mëshqerrat në një moshë lindjeje të parë ndërmjet 24 dhe 28 muaj kanë një rendiment më të lartë se lopët që lindin më vonë.

Tabela 1: Situata në fermë

100 lopë		47 viça femër/vit				
50% viça femër/50 % viça meshkuj		5% Shkalla e dështimit gjatë rritjes				
5% humbjet në viça rreth periudhës së pjelljes		370 ditë periudhë mes dy pjelljesh				
Shkalla e skartimit	Kafshë të nevojshme	Numri i viçave që do të mbahen				
në %	në vit	mosha e lindjes së parë (muaj)				
24	26	28	30	32		
25	26	52	56	61	65	69
30	32	64	69	75	80	85
35	37	74	80	86	93	99
45	47	94	102	110	118	125

Mëshqerrat në këtë moshë lindjeje të parë japin në 305 ditë laktacioni afërsisht 10.350 kg qumësht. Mëshqerrat në moshë lindjeje të parë ndërmjet 28 dhe 30 muaj kanë një prodhimtari pak më të lartë. Megjithatë te këto kafshë investohet mesatarisht tre muaj më shumë në rritjen e tyre.

Në vitet e fundit Hülsenberg (stacioni kërkimor i Schaumann) uli mesataren e moshës së lindjes së parë nga mbi 29 muaj në afërsisht 25,5 muaj. Është e rëndësishme të theksohet, që gjatë periudhës së kullotjes kafshët që mund të insemoheshin, u insemuan dhe muajt e verës nuk u llogaritën në moshën e lindjes së parë.


Intesiteti i rritjes

Në momentin e lindjes, lopët duhet të jenë në fazën e duhur të zhvillimit (tabela 2). Nëse duhet të realizojmë pjelljen e parë në një moshë më të hershme, duhet të synojmë një rritje intensive të viçit.

Në Hülseberg u praktikua me sukses pjellja e parë në një moshë më të re. Periudha 2-javore e kulloshtrës mbyllet me produktin “Kalbi Milch Premium Spezial”. Krahas këtij produkti u ofrohet shtesë dhe Kalbi Flocs në sasi të vogla. Në 5-6 javët e para viçat ushqehen me “Kalbi Milch Premium Sweet”. Si fillim, paralelisht me këtë ata marrin “ad libitum Kalbi Flocs”, që shoqërohet me një ushqim për rritjen e viçave, i cili përmban “Kalvicin Pro”. Pas shkëputjes viçave u ofrohet racion ushqimor i përzier i lopëve me qumësht për një periudhë afërsisht 10- mujore. Racioni i përzier, i cili është i pasur me të gjitha vlerat ushqimore, përmbush më së miri kriteret për zhvillimin e duhur. Në një vit viçat peshojnë afërsisht 370 kg. Në muajin e 15-të fillon inseminimi në Hülseberg. Për kafshët që peshojnë më pak inseminimi fillohet afërsisht dy muaj më vonë.

Viçat në Hülseberg fillojnë të kullojnë pasi kanë mbushur 10 muaj. Në këtë mënyrë sigurohet, që zhvillimi në vitin e parë bëhet siç duhet, me një rritje ditore afërsisht 900 gr, sepse në periudhën që dalin në kullotje është shpesh e vështirë të arrihet një rritje ditore mbi 500 gr.

Tabela 2. Ndikimet e rritjeve të ndryshme ditore në moshën e lindjes së parë (pesha finale: 700kg)



Kostot e e rritjes

Studimet e dy viteve të fundit treguan një kosto totale prej 1.150 euro/kafshë. Kostot direkte arritën afërsisht vlerën 800 euro/viç. Kostot indirekte (p.sh kostot e punës, kostot e ndërtesës, kosto të tjera) arritën një vlerë prej 350 euro. Shifrat tregojnë se pavarsisht intensitetit më të lartë për shkak të shkurtimit të kohës së zhvillimit, kostot e zhvillimit mund të reduktohen.

Raportet gjithashtu theksojnë se shitja e kafshëve të remontit, ka kuptim vetëm në momentin kur çmimi i mëshqerrave në treg është relativisht i lartë.